

RREGULLORE
Nr.83, datë 7.11.2001

PËR EKSPORT-IMPORTET E KARTËMONEDHAVE DHE TË MONEDHAVE
METALIKE SHQIPTARE

Kjo rregullore nxirret në mbështetje të nenit 34 kreu V të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë.”

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë kritere për sasinë dhe procedurat për:

- a) eksport - importet e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor;
- b) nxjerrjen dhe sjelljen nga dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë të kartëmonedhave e monedhave metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor.

Neni 2

Përkufizime

Sa herë që përdoren në këtë rregullore, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

1. “Kartëmonedhë” është biletë banke e emtuar nga Banka e Shqipërisë dhe që ka kurs ligjor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. “Monedhë” është monedha metalike e emtuar nga Banka e Shqipërisë dhe që ka kurs ligjor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. “Kurs ligjor” kupton detyrimin ligjor për të pranuar kartëmonedhat dhe monedhat metalike, që nuk janë tërhequr nga qarkullimi për të gjitha pagesat e detyrimeve publike e private pa kufizim, me vlerën e tyre nominale.
4. “Cash” është kartëmonedha dhe monedha metalike në qarkullim (që nuk është tërhequr nga qarkullimi me akte nënligjore të Bankës së Shqipërisë), që eksportohet dhe importohet apo nxirret e silllet nga dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë fizikisht.
5. “Eksport” është nxjerrja në cash nga territori i Republikës së Shqipërisë e kartëmonedhave dhe e monedhave metalike shqiptare, që kanë ose jo kurs ligjor, për veprimtari shitjeje për qëllime numizmatike.
6. “Import” është futja në cash në territorin e Republikës së Shqipërisë e kartëmonedhave dhe e monedhave metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor.
7. “Person” është çdo person fizik dhe juridik, që është i njohur për të kryer veprimtari shitblerjeje në fushën e numizmatikës.
8. “Individ” kupton çdo shtetas shqiptar ose të huaj, rezident ose jorezident.

KREU II
EKSPORT-IMPORTI

Neni 3

Banka e Shqipërisë është institucioni i njohur nga ligji, që importon dhe eksporton kartëmonedha e monedha metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor. Sasia dhe procedurat për importet dhe eksportet që ajo kryen përcaktohen nga vetë Banka e Shqipërisë.

Neni 4

Importi i kartëmonedhave e monedhave metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor, është e drejtë ekskluzive e Bankës së Shqipërisë.

Neni 5

Në mbështetje të nenit 3 të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë realizon shitje të kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shqiptare, që kanë ose jo kurs ligjor, për qëllime numizmatike, duke shitur në sportelet e saj, por edhe duke i eksportuar në drejtim të blerësit të vendit të huaj, në përputhje me rregullat procedurale dhe për sasi të miratuara prej saj.

Neni 6

Banka e Shqipërisë autorizon të eksportojnë, për qëllime numizmatike, kartëmonedha e monedha metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor, edhe persona të tjerë që janë ligjërisht të njohur për të kryer veprimtari shitblerjeje në fushën e numizmatikës.

Neni 7

Në zbatim të nenit 6 të kësaj rregulloreje, autorizimi për të eksportuar jepet me shkrim dhe vetëm për sasi të kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor, të blera në Bankën e Shqipërisë.

Neni 8

Kartëmonedhat dhe monedhat metalike shqiptare, të hequra nga qarkullimi (që nuk kanë kurs ligjor), janë lirisht të eksportueshme.

KREU III

NXJERRJA DHE SJELLJA NGA JASHTË SHTETIT E KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE METALIKE SHQIPTARE, QË KANË KURS LIGJOR

Neni 9

çdo individ lejohet të marrë me vete dhe të nxjerrë në cash nga territori i Republikës së Shqipërisë kartëmonedha e monedha metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor, në shumën deri në 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Neni 10

Individët, që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, mund të sjellin në cash kartëmonedha e monedha metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor, në shumën deri në 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 11

Rregullorja “Për nxjerrjen dhe sjelljen nga jashtë shtetit të kartëmonedhave e monedhave metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor, e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me

vendimin nr.34, datë 2.5.2001, shfuqizohet.

Neni 12

Kjo rregullore u miratua me vendimin nr.83, datë 7.11. 2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim Cani